

NJOFTIM PUNËSIMI

Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK	<p>Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë.</p> <p>Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj për një vënd pune: Elektro-Pompist/e pranë Stacionit të Pompimit/Fshati Hasan në Drejtorinë e Prodhimit dhe Transmetimit të Ujit nisur nga data më e afërt. Punëmarrësi i ri do të jetë përgjegjës për inventarin e makinerive dhe pajisjeve që ka në përdorim stacioni i pompimit. Detyrat përfshijnë gjithashtu gatishmërinë dhe shfrytëzimin sipas rregullave të teknikës stacionin e pompimit.</p>
Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:	<ul style="list-style-type: none">• Merr dhe dorëzon turnin duke shënuar në formatin e caktuar nga Shoqëria në librin e shënimeve,problemet e konstatuara gjatë turnit.• Për stacionet me elektrikist, lëshimi i pompave bëhet në bashkëpunim midis pompistit dhe elektrikistit. Për Stacionet pa elektrikist, pompisti manovron vetë për vënien në punë të elektro-pompave bazuar në rregulloren teknike.• Mban lidhje me Përgjegjësën e Turnit për probleme që dalin gjate turnit.• Nuk largohet nga turni pa i ardhur ndërruesi.• Merr pjesë në remontet e kryera nga grupi i remonteve mekanike.• Zbaton me përpikëri Rregulloren e Sigurimit Teknik në punë. Çdo vit del para komisionit të sigurimit teknik për t’u pajisur ose rifreskuar dëshminë përkatëse. Në të kundërt i hiqet e drejta për të punuar në shfrytëzimin e elektro-pompave si pompist.

	<ul style="list-style-type: none"> Nxjerr jashtë pune pusët nga të cilët konstatohet së uji vjen me ndotje (i turbullt, etj.) në bashkëpunim me klorinuesin dhe njofton menjëherë Përgjegjësin e Turnit.
Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:	<ul style="list-style-type: none"> Eksperiencia pune të mëparshme. Librezë e Punës Certifikatë Familjare Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës Dy fotografi Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar Dëshmi Penaliteti Raporti Mjekësor Vërtetim Vendbanimi
Kushtet e punës:	<ul style="list-style-type: none"> Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur. Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.
<ul style="list-style-type: none"> Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 25.05.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar. 	